



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 06.03.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-88/24, për zyrtarin e lartë z. Prindon Sadriu, Ministër në Mision Diplomatik, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur lidhur me papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Prindon Sadriu, Ministër në Mision Diplomatik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas një raportimi të jashtëm në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe *kërkesës për sqarim* nga vet zyrtari i lartë z. Prindon Sadriu, lidhur me funksionin/et që mban në Organizatën Joqeveritare (OJQ) 'CIOR - Kosovo Reserves Officers' Association (*Shoqata e Oficerëve Rezervë të Kosovës*).

Më gjerësisht në kërkesën e tij z. Sadriu ka deklaruar se (*citojmë nga kërkesa*):

"[...]..ju kërkoj me konsideratë sqarime lidhur me mbajtjen e pozitës së Personit të Autorizuar në Shoqatën e Oficerëve Rezervë të Republikës së Kosovës. Kjo pas raportimeve të disa medimeve elektronike gjatë javës së kaluar për kinse konflikt interesi në ushtrimin e pozitës së Personit të Autorizuar në OJQ.

Fillimisht me lejoni të ju njoftoj se OJQ është themeluar në pajtueshmëri të plotë me Ministrinë e Mbrojtjes me qëllim të avokimit dhe lobimit për ushtaraket rezervë të FSK-se si dhe për ndërkombëtarizimin e komponentit rezervë deri në anëtarësimin me të drejta të plota në organizatën ombrellë të NATO-s për rezervë, CIOR (<https://cior.net/>) e themeluar në vitin 1949. Ju njoftoj gjithashtu se karakteri i Shoqatës, për dallim nga OJQ-të tjera është i veçantë sepse, për dallim nga rastet tjera, është i hapur për anëtarësim vetëm për personat

që kanë status të rregullt punë me Ministrinë e Mbrojtjes, respektivisht me FSK-në në cilësi të ushtarakut rezervë. Pra, organizimi në këtë trupë është i mundur vetëm për të punësuarit në MM dhe FSK-së, por njëkohësisht nuk i takon karakterit sindikal sepse një organizim i tillë sindikal nuk lejohet për FSK-së në bazë të legjislacionit në fuqi. Për fat të keq, legjislacioni në MM nuk ka lejuar mundësin tjetër të organizimit përpos atij të Ligjit për OJQ (që është rasti edhe për disa organizata tjera të NATO-së, përfshi rasti i ROA në SHBA), derisa potencialisht të bëhet amandamentimi i njërit nga Ligjet e MM-së përmes të cilit do të adresohet çështja e organizatës së oficerëve rezervë të Kosovës. Ju njoftoj gjithashtu që gjitha shtetet e kontinentit të Evropës dhe ato të NATO-s kanë organizata të tilla dhe funksionojnë mbi baza vullnetare dhe pro-bono, pa pagese. Republika e Kosovës është shteti i fundit të Evropë që nuk ka patur organizim të tillë të Oficerëve rezervë dhe as bashkëpunim me CIOR përmes së cilit do të merr përsipër ngritjen e kapaciteteve trajnuese për oficerët rezervë të FSK-së dhe përfitimin nga shumë programe tjera që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse në komponentin e forcave rezervë të NATO-s. E njëjta vlen edhe për organizatën tonë e cila në statut përkufizon pamundësinë për tu paguar ose shpërblyer në çfarëdo forme. Gjitha aktivitetet e deritanishme janë mbuluar nga shpenzimet vetanake, përfshi edhe udhëtimet në Tiranë dhe Shkup ku kemi mbajtur takime dhe koordinime lidhur me anëtarësimin tonë në organizatën ombrelle të NATO-s në Bruksel, CIOR. OJQ nuk ka as llogari bankare të dhe as nuk ka përfituar asnjë financim ose donacion të vetëm.

Shoqata nga viti 2020 ka statusin e njohur nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe deri tani ka të nënshkruar edhe marrëveshje me organizatën e Oficerëve Rezerve në Shqipëri dhe është në diskutim e sipër për të përmbyllur një bashkëpunim edhe me organizatën e Maqedonisë së Veriut, ORORMS(<https://www.facebook.com/ORORMS>. Rezervni Oficeri/) dhe atë të SHBA-ve, Rezervë Organization of America ROA [https://nrd.gov/resource/detail/8674810/Reserve+Organization+of+America#:~:text=The%20Reserve%20Organization%20of%20America,National%20Oceanic%20and%20Atmospheric%20Administration%20C\)](https://nrd.gov/resource/detail/8674810/Reserve+Organization+of+America#:~:text=The%20Reserve%20Organization%20of%20America,National%20Oceanic%20and%20Atmospheric%20Administration%20C),), trijat anëtare me të drejta të plota në CIOR të NATO-s.

OJQ nuk ka ende kryetar, por ka vetëm Këshillin iniciues dhe Personin e autorizuar, pra në këtë rast jam unë në cilësi të personit të autorizuar në këtë OJQ, përderisa anëtarët tjerë të këtij Këshilli janë gjithashtu figura që mbajnë pozitën e ushtarakut rezervë (oficerit) në FSK.

Prandaj, me qëllim të evitimit të keqkuptimit të rolit tim në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe pozitës së Personit të Autorizuar, kërkoj me konsiderate sqarimin e pozitës së Personit të Autorizuar në OJQ”.

Më pas, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pasur edhe dy komunikime (përmes telefonit) me zyrtarin e lartë z. Prindon Sadriu, me ç'rast është njoftuar për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajftueshmërisë, pasi që zyrtari i lartë (Ministër në Mision Diplomantik), nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësues i autorizuar në OJQ, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajftueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin

14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe sqarimit të të gjitha fakteve, zyrtari i lartë është pajtuar me konstatimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar se do të ndërmarra veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, pas verifikimeve të duhura, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar se zyrtari i lartë në fjalë ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia, të cilat mund të dëshmohen edhe përmes uebfaqes zyrtare të Departamentit për OJQ-të, e ku e njëjti nuk figuron më të jetë përfaqësues i autorizuar apo të ketë funksione drejtuese në atë OJQ.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Për Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit